



PËRDITËSIM

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore Thaçi dhe të tjerë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake dje, më 30 nëntor, njoftoi zyrtarisht Kryetaren e Dhomave të Specializuara të Kosovës se çështja do të jetë gati për t'iu kaluar Trupit Gjykues të enjten, më 15 dhjetor 2022.

Pas njoftimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, Kryetarja po atë ditë caktoi Trupin Gjykues II për çështjen gjyqësore, i përbërë prej gjykatësve Çarls Smith, Kristof Barte, Ginel Metro dhe Fergal Gejnor, si gjykatës rezervë.

Më 28 nëntor, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hodhi poshtë kërkesën e z. Thaçi për të dëgjuar dëshminë e 9 dëshmitarëve para fillimit të gjykimit. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se Mbrojtja nuk vërtetoi se gjendja shëndetësore e këtyre dëshmitarëve përbën shqetësim serioz, duke theksuar se thjesht moshë nuk mjafton për të besuar se dëshmitë nuk do të jenë të disponueshme gjatë paraqitjes së provave nga Mbrojtja. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vuri në dukje se çështja gjyqësore do t'i kalohet Trupit Gjykues shumë kohë para shkurtit, që është koha kur Mbrojtja e Thaçit kërkoi që të dëgjohej dëshmitarët.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, Kryetarja caktoi Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi apelet e z. Thaçi dhe z. Selimi kundër vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake me të cilin autorizoi Prokurorinë të ndryshonte listën e dëshmitarëve dhe të provave materiale. Paneli i Apelit që u caktua për të vendosur mbi këto apele përbëhet prej gjykatësve Mishelë Pikar, Emilio Gati dhe Nina Jorgensen.

Në çështjen gjyqësore të Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt, Paneli i Gjykatës së Apelit në vendimin e vet të datës 16 nëntor, hodhi poshtë kërkesën e z. Haradinaj për lirim të përkohshëm për arsye humanitare në një shtet të tretë. Paneli e hodhi poshtë kërkesën mbi bazën se Haradinaj nuk dorëzoi dokumentacionin mjekësor të nevojshëm për të arsyetuar kërkesën, e as nuk ka dorëzuar dokumente në lidhje me gatishmërinë e shtetit të tretë për mundësim të këtij lirimi.

Sot dhe nesër, më 1 dhe 2 dhjetor, do të mbahet seancë e apelit në këtë çështje gjyqësore. Sipas rendit të ditës të caktuar nga Paneli i Apelit, ekipeve të Mbrojtjes do t'u jepet mundësia të paraqesin argumentet e tyre gojarisht. Prokurorisë do t'i jepet mundësia të përgjigjet, dhe ekipet e Mbrojtjes mund t'i kundërpërgjigjen përgjigjes së Prokurorisë. Që të dy, z. Gucati dhe Haradinaj gjithashtu do të kenë mundësinë t'i drejtohen personalisht Panelit të Apelit, nëse dëshirojnë.





Publiku mund ta ndjekë seancën në shqipe, serbishte dhe anglishte, ose nga galeria për publikun e Dhomave të Specializuara, ose në internet, nëpërmjet faqes së internetit të Dhomave të Specializuara.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

